

GRUPI A

1. Brinjët e një trekëndëshi rrinë si 5:6:8. Gjeni brinjët e një trekëndëshi të ngjashëm me të. Nëse trekëndëshi i dytë ka brinjën më të vogël 20cm.


2. Njëra diagonale e trapezit është 21cm. Ajo ndan diagonalen tjetër në dy pjesë me gjatësi 2cm dhe 5cm. Të gjenden segmentet e diagonales së parë.

3. Një katror dhe një trekëndësh barabrinjës kanë perimetra të barabartë. Gjeni raportin e sipërfaqeve të tyre.

4. Gjeni këndin e tetëkëndëshit të rregullt. Gjeni këndin qëndror të tij.

5. Brinja e trekëndëshit të rregullt të brendashkruar në rreth është 8cm. Gjeni brinjën e katrorit të brendashkruar në atë rreth.

6. Tregoni pse janë të ngjashëm trekëndëshat dhe gjeni x në figurën e mëposhtme.




7. Pjestoni polinomin  $2x^3 - 3x^2 + 5x + 1$  me  $x - 2$

Ushtrimet vlerësohen me nga 3 pikë secil.

0-4	5-7	8-10	11-13	14-16	17-19	20-21
4	5	6	7	8	9	10

GRUPI B

1. Në figurë jepet  $AE = EB$  dhe  $BC \parallel AD$ . Të vërtetohet se ABCD është paralelogram.



2. Brinjët e një trekëndëshi rrinë si 5:6:8. Gjeni brinjët e një trekëndëshi të ngjashëm me të nëse trekëndëshi i dytë ka brinjën më të madhe 32cm


3. Në trapezin ABCD ( $AB \parallel CD$ ) jepet baza e madhe  $AB = 10$ cm. Zgjatimet e brinjëve anësore të tij priten në pikën në pikën M. Gjeni vijën e mesme të trapezit.  $AM = 5, AD = 4$

4. Një katror dhe një trekëndësh barabrinjës kanë sipërfaqe të barabarta. Gjeni raportin e perimetrave të tyre.

5. Gjeni këndin e 12-këndëshit të rregullt. Gjeni këndin qëndror të tij.

6. Pjestoni polinomin  $x^3 - 5x^2 + 1$  me  $x + 2$

7. Tregoni pse janë të ngjashëm trekëndëshat dhe gjeni x në figurën e mëposhtme



Ushtrimet vlerësohen me nga 3 pikë secil.

0-4	5-7	8-10	11-13	14-16	17-19	20-21
4	5	6	7	8	9	10

GRUPI C

1. Mbi përgjysmoren e një këndi O, ndërtohet një drejtëz pingule me të e cila pret brinjët e këndit në pikat M dhe N. Të vërtetohet se  $OM = ON$ .

2. Brinjët e një trekëndëshi rrinë si 5:6:8. Gjeni brinjët e një trekëndëshi të ngjashëm me të nëse trekëndëshi i dytë ka diferencën e brinjës më të madhe me brinjën më të vogël 6cm.


3. Katrorit me brinjë 8 cm i brendashkruhet dhe jashtëshkruhet rrethi. Të gjendet rrezja e secilit rreth.

4. Rrethit me rreze  $R = 8$ cm i jashtëshkruhet katrori. Gjeni diagonalen e katrorit.

5. Këndet e një trekëndëshi rrinë si 3:4:5. Gjeni raportin e brinjëve të tij.

6. Tregoni pse janë të ngjashëm trekëndëshat dhe gjeni të panjohurat në figurat e mëposhtme

Pjestoni polinomin  $x^4 - x^2 + 5x - 4$  me  $x - 3$



Ushtrimet vlerësohen me nga 3 pikë secil.

0-4	5-7	8-10	11-13	14-16	17-19	20-21
4	5	6	7	8	9	10